

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-58/021	Data: Datum: 01.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-7025, të datës 23.02.2021, e parashtruar nga Adem Avdijaj, Përfaqësues ligjor i Komunës nga fshati Sinajë, Komuna Istogut për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së prindit-nënës (Hala Avdijaj), nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-7025, të datës 23.02.2021, e parashtruar nga Adem Avdijaj, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së nënës (Hala Avdijaj) dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej **389.20 €** (treqind e tetëdhjetë e nentë euro e njëzet cent) nga programi buxhetor i Zyrës së Krytarit të Komunës, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere si ndihmë për familjen e të lartpërmendurit.
2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Adem Avdijaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Adem Avdijaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-59/021	Data: Datum: 01.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-7432, të datës 26.02.2021, e parashtruar nga Sami Shatri nga fshati Tomoc, Komuna Istogut për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së prindit-nënës (Kadire Shatri) i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-7432, të datës 26.02.2021, e parashtruar nga Sami Shatri, Zyrtar për Gjendje Civile 4, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së nënës (Kadire Shatri) dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej **389.20 €** (treqind e tetëdhjetë e nentë euro e njëzet cent) nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit të Komunës, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere si ndihmë për familjen e të lartpërmendurit.
2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Sami Shatrit, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Sami Shatri, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-61/021	Data: Datum: 02.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 08/2017 për Plotësim dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë, shqyrtoj kërkesën 504/2021, të datës 12.01.2021, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale, për përkrahje financiare të familjës strehuese, e pranuar për shqyrtim nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me datën 09.03.2021, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 504/2021, të datës 12.01.2021, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e cila ka përzgjedhur familjen strehuse të Liridona dhe Arsim Rexhaj nga fsh.Muzhevinë, Komuna e Istogut të cilët bëjnë strehimin e fëmijëve të braktisur dhe përkujdeset për ta, kështu që për këtë qellim i ndahen mjete financiare në vlerë prej 100€ (njëqind euro), për se cilin fëmijë që strehon për çdo muaj, nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Për ta ruajtur familjën strehuese komuna ndan mjete financiare në vlerë nga 50€ (pesdhjetë euro) për çdo muaj deri sa të ketë fëmijë për strehim.
3. Ky vendim fillon të zbatohet nga data 01.11.2020 dhe vazhdon deri ne momentin kur Qendra për Punë Sociale e konststton se familja don me nderpre statusin e familjës strehuese.
4. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e familjës strehuese, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiive.
5. Qendra për Punë Sociale obligohet të mbikqyrë gjëndjen e fëmijëve dhe të famijës strehuese për çdo muaj, të bejë raport dhe të sjell raportin në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
6. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdsen: Qendra për Punë Sociale dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
7. . Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër këtij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi

Me kopje e këtij Vendimi njoftohen: Liridona dhe Arsim Rexhaj-familje strehuse, Qendra për Punë Sociale, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe një kopje mbete në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-62/021	Data: Datum: 02.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport, shqyrtoi kërkesën se bashku me projekt-propozimin Nr.12-400-6193 të datës 16.02.2021 të parashtruar nga OJQ "Folklori i Podgurit" për përkrahje financiare dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.12-400-6193 të datës 16.02.2021 e parashtruar nga OJQ "Folklori i Podgurit" dhe i ndahen 500.00 euro (pesqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kultur, Rini dhe Sport, për realizimin e projektit "Manifestimi i 13 i Pervjetorit të Shpalljes së Pavarsisë së Republikës së Kosovës".
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ "Folklori i Podgurit" në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

OJQ "Folklori i Podgurit", ka parashtruar kërkesën Nr.12-400-6193 të datës 16.02.2021, për përkrahje financiare për Manifestimin e 13 të Pervjetorit të Shpalljes së Pavarsisë së Republikës së Kosovës. Kryetari shqyrtoi kërkesën e OJQ-së dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Për shkak të rëndësisë së Manifestimit të Pervjetorit të Shpalljes së Pavarsisë së Republikës së Kosovës përkrahet financiarisht OJQ "Folklori i Podgurit" sipas tabelës së buxhetit për shpenzime të paraqitura në projekt-propozim, nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kultur, Rini dhe Sport. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e OJQ "Folklori i Podgurit", në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

Për sa u theksua me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit njoftohen: OJQ "Folklori i Podgurit", Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Flaki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-65/2021	Data: Datum: 08.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-4649, të datës 04.02.2021, e parashtruar nga z.Fahri Balaj, nga fsh.Zabllaq, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-4649, të datës 04.02.2021, e parashtruar nga z.Fahri Balaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Fahri Balaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Fahri Balaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-4649, të datës 04.02.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Fahri Balaj është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Fahri Balaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Fahri Balaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-68/2021	Data: Datum: 11.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën 11 Nr.20/2021 të datës 11.03.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) Istog”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxhere e kontratës, **Elfete Blakaj**, Udhëheqëse e Sektorit Mbrojtje të Mjedisit në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe **CAKTOHET:** Mbikqyrës i drejtpërdrejt i Menaxheres së kontratës **Jashar Blakaj**, Drejtor i DPUM për projektin: “Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) Istog” me numer të jashtëm prokurimi 633-021-249-2-3-6 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-001-236 të cilin është duke e realizuar operatori N.SH “GEO-MININGU” nga Prishtina.
2. Menaxherja e kontratës dhe Mbikqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxheres së kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartëcekur e merr Menaxherja e kontratës dhe Mbikqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxheres së kontratës.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi është përfundimtar.


Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Elfete Blakaj**, **Jashar Blakaj**, **N.SH “GEO-MININGU”**, **Prokurimi** dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Zyrtari Kryesor Administrativ
z.Haki RUGOVA





Republika e Kosoves
Republika Kosovo
Republic of Kososov



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istok

Komisioni Komunal për Riintegrim/ Municipal Commission for Reintegration/ Opštinska Komisija za Reintegraciju

Nr. 01-71/2021
Datë: 15.03.2021

Komisioni Komunal për Riintegrim , bazuar në nenin 3 (paragrafi 1.3), nenin 35 (paragrafi 1, 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5), nenin 21 (paragrafi 1, 2, dhe 4), neni 44 (paragrafi 1, 2, 3, 4, 4.1 dhe 5) të Rregullores QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegrit, mbështetur në Vendimin Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa e **Hikmete Dollci**, e riatdhesuar nga **Gjermania** me datë 29.06.2020 për mbështetje nga programi i Riintegrit për **vazhdimin e akomodimit me qira** sipas kërkesës nr të kërkesës **10-553-6652** të parashtruar në Komunën e Istogut, për 2 persona duke filluar nga data **01.03.2021** deri me **01.09.2021** në vlerë **180.00€** në muaj.
2. Përfitues nga pika 2 e këtij vendimi është familja dy (2) anëtarëshe nga Komuna e Istogut
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Komunal për Riintegrim në mbledhjen e mbajtur me datë 03.03.2021, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar me datë 19.02.2021 nga e riatdhesuara Hykmete Dollci në Komunën e Istogut.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuara, duke përfshirë dëshminë e ofruara, dhe sipas dëshmive të paraqitura, konstaton se i riatdhesuari i **plotëson** kriteret për mbështetje nga Programi i Riintegrit të përcaktuara me Rregulloren QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegrit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Periudha e vazhdimin të pagesës së qirasë për personin e riatdhesuar Hykmete Dollci, fillon nga data 01.03.2021 deri me datë 01.09.2021, në vlerë 180€ në muaj, sipas ofertës më të lirë të ofruar nga personi i riatdhesuar (oferta 2).

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimit të tij, mund të paraqes ankesë në Komisionin e Ankesave .

Istog, më 15.03.2020

Kopja e vendimit i dërgohet:

Arkivit të Komunës
Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
Koordinatorit Rajonal të MBP-së
Personit të riatdhesuar



z. Maki Rugova
Kryetar i Komunës së Istogut

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-67/2021	Data: Datum: 09.03.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 44 të Rregullorës (QRK)-së 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, shqyrtoj kërkesën e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-791/018 të datës 14.11.2018, për formimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni Komunal për Riintegrim i cili do të shqyrtoj dhe të vendos për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitim nga skemat e riintegritit dhe në komision caktohen:

- 1.1. Fisnik Shoshi, (DSH), Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Muhamet Gusturanaj (ZIE), anëtar;
- 1.3. Florije Bytyçi (DKA), anëtare;
- 1.4. Muhamed Maleshaj (ZKKK), anëtar;
- 1.5. Ismet Hasi (KGJ), anëtar;
- 1.6. Myrvete Verbaj (QPS), anëtare,
- 1.7. Rustem Gashi (DPUM), anëtar;
- 1.8. Naser Nimanaj (DSHPMSH), anëtar;
- 1.9. Faton Bujupi (ZL-P), anëtar;
- 1.10. Sahadete Aliu (GJC), anëtare; dhe
- 1.11. Sefer Ademaj (ZP), anëtar

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të shqyrtoj dhe të vendos për të gjitha kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitim nga skemat e riintegritit, në bazë të Rregullorës (QRK)-së 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe në bazë të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurë të Përgjithshme Administrative.

3. Vendimet i nxjerr Komisioni Komunal për Riintegrim dhe i nënshkruan Kryetari i Komunës.

4. Të gjitha punët administrativo-teknike për nevojat e KKR-së do ti kryej ZKKK duke përfshirë evidentimin e kërkesave dhe dorzimimin e tyre të KKR, si dhe do ti kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdeset Komisioni Komunal për Riintegrim dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

6. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: KKR, ZKKK dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-72/2021	Data: Datum: 15.03.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndertimi i Deponise ne Tuqep” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-597-521 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-003-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndertimi i Deponise ne Tuqep” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-597-521 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-003-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe
- 1.3. **Shaban Gerguri**, Përfaqesues KRM-Istog, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: “Ndertimi i Deponise ne Tuqep” si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-73/2021	Data: Datum: 15.03.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim shqyrtoi kërkesën Nr.08-553-3009 të datës 25.01.2021 të parashtruar nga Jeton Imeraj nga fsh. Padalishtë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompenzim demi të shkaktuar nga zjarri dhe i propozon Kryetari të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08-553-3009 të datës 25.01.2021 e parashtruar nga Jeton Imeraj, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për ndërtimin e shtëpisë së banimit e cila është djegur në terësi nga rryma dhe i ndahen 2,500.00€ (dymijë e pesëqind euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Jeton Imeraj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Jeton Imeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.08-553-3009 të datës 25.01.2021 me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për të ndërtimin e shtëpisë së banimit e cila i është djegur në terësi nga rryma.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga Raporti i zjarrfiksave shihet se është djegur shtëpia e Jeton Imeraj i cili jeton me pesë anëtar të familjës, gjendjen ekonomike e ka jo të mirë dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të ndërtoj shtëpinë, andaj i ndihmohet me mjete financiare në shumë prej 2,500.00€ (dymijë e pesëqind euro).

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Jeton Imeraj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Jeton Imeraj, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-74/2021	Data: Datum: 15.03.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Trajtimi, Kastrimi dhe Sterilizimi i Qeneve Endacak" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-620-221 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-004-221, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Trajtimi, Kastrimi dhe Sterilizimi i Qeneve Endacak" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-620-221 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-004-221 dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Naser Gjoci**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar dhe
- 1.3. **Valbone KalIQani**, Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare.


2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Trajtimi, Kastrimi dhe Sterilizimi i Qeneve Endacak" si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.75/2021	Data: 16.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58, pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008):

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d), nenit 17 pika c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 10, paragrafi 10.2 të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokat Bujqësore, nenit 6 paragrafi 6.3, neni 8 paragrafi 8.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, nenin 32 dhe 33 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr. 62/10 i datës 30.11.2010, kërkesës Nr. 11-016-2228 të datës 18.01.2021 për ndërrimin e përhershëm të destinimit nga toka bujqësore në tokën ndërtimore Njësitë Kadastrale: 512-1, 512-2, 512-4, 512-5, 516-6 dhe 512-7, Zona Kadastrale- Llukac i Thatë, në pronësi të Selman Haxhijaj, që në mbledhjen e mbajtur më ___/03/2021 të merr këtë:

V E N D I M PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

- MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr.75/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore, Njësitë Kadastrale: 512-1, 512-2, 512-4, 512-5, 516-6 dhe 512-7, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.36.85 ha, Zona Kadastrale- Llukac i Thatë.
- Sipas pikës 1 të këtij propozim-vendimi tokat bujqësore, Njësitë Kadastrale: 512-1, 512-2, 512-4, 512-5, 516-6 dhe 512-7, janë livadh i klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0.36.85 ha të evidentuara sipas certifikatës pronësore: P-70806048-00512-1, P-70806048-00512-2, P-70806048-00512-4, P-70806048-00512-5, P-70806048-00512-6 dhe P-70806048-00512-7, Zona Kadastrale- Llukac i Thatë, prona private në pronësi të Selman Haxhijaj, **destinohen në toka ndërtimore.**
- Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore në tokë ndërtimore sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi do të paguhet në procedurë administrative të marrjes së lejes së ndërtimit sipas dispozitave të nenit 14, paragrafi 14.2, pika b) e Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore.
- Obligohet pronari i paluajtshmërive të lartcekura që ndërrimin e destinimit ta shfrytëzoj vetëm sipas kërkesës së parashtruar.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe 7 ditë pas shpalljes së tij publike në ueb faqen e komunës.

Më kopje të këtij vendimi të njoftohen: MAPL, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor Gjeodezi, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi një kopje në arkivin e Kuvendit.

Zyrtari Ligjor,
Faton Bujupi

Faton Bujupi



Kryetari i Komunës,
Z. Haki Rugova

Z. Haki Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.76/2021	Data: 16.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58, pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008):

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d), nenit 17 pika c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 10, paragrafi 10.2 të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokës Bujqësore, nenit 6 paragrafi 6.3, neni 8 paragrafi 8.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, nenin 32 dhe 33 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr. 62/10 i datës 30.11.2010, kërkesës Nr. 11-016-4677 të datës 04.02.2021 për ndërrimin e përhershëm të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore Njësinë Kadastrale 138-2, Zona Kadastrale- Llukac i Thatë, në pronësi të Rexhë Hajraj, që në mbledhjen e mbajtur më ____/03/2021 të merr këtë:

V E N D I M

PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

- MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr.76/2021 i datës 16.03.2021 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore, Njësinë Kadastrale 138-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.19.60 ha, Zona Kadastrale- Llukac i Thatë.
- Sipas pikës 1 të këtij propozim-vendimi toka bujqësore, Njësia Kadastrale 138-2 është arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0.19.60 ha e evidentuar sipas certifikatës pronësore: P-70806048-00138-2 Zona Kadastrale- Llukac i Thatë, pronë private në pronësi të Rexhë Hajraj, **destinohet në tokë ndërtimore.**
- Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi do të paguhet në procedurë administrative të marrjes së lejes së ndërtimit sipas dispozitave të nenit 14, paragrafi 14.2, pika b) të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore.
- Obligohet pronari i paluajtshmërisë së lartcekur që ndërrimin e destinimit ta shfrytëzoj vetëm sipas kërkesës së parashtruar.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe 7 ditë pas shpalljes së tij publike në ueb faqen e komunës.

Më kopje të këtij vendimi të njoftohen: MAPL, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor Gjeodezi, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi një kopje në arkivin e Kuvendit.

Zyrtari Ligjor,
Faton Bujupi



Kryetari i Komunës,
Z. Haki Rugova



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-77/2021	Data: Datum: 16.03.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: “Blerja dhe Furnizimi me Gypa te Kanalizimit dhe Ujesjellësit” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-676-121 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-005-121, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Blerja dhe Furnizimi me Gypa te Kanalizimit dhe Ujesjellësit” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-676-121 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-005-121 dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe
- 1.3. **Shfqet Imeraj**, Zyrtar i Prokurimit 2, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: “Blerja dhe Furnizimi me Gypa te Kanalizimit dhe Ujesjellësit” si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-78/021	Data: Datum: 17.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-9335, të datës 11.03.2021, e parashtruar nga Osman Sadikaj nga Komuna Istogut për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së dy prindërit-nënës (Shkurte Sadikaj) dhe babait (Shaban Sadikaj), nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-9335, të datës 11.03.2021, e parashtruar nga Osman Sadikaj, Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Finacave, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së dy prindërit-nënës (Shkurte Sadikaj) dhe babait (Shaban Sadikaj) dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej 778.4 € (shtatëqind shtatedhjetë e tetë euro e katër cent) nga programi buxhetor i Zyrës së Krytarit të Komunës, kategoria ekonomike paga dhe medijtje kodi ekonomik 11155-shtesat dhe kompenzimet tjera (vendim) si ndihmë për familjen e të lartpërmendurit.
2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Osman Sadikaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Osman Sadikaj , Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-81/021	Data: Datum: 22.03.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: **“FURNIZIM ME MEDIKAMENTE TE TERAPISE SE PËRGJITHSHME, PËR NEVOJA TE QKMF DHE SHTËPISË PËR KOMUNITETE”** më numër të brendshëm prokurimi 633-021-006-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit me nr: 633-21-819-1-2-1 **“FURNIZIM ME MEDIKAMENTE TE TERAPISE SE PËRGJITHSHME, PËR NEVOJA TE QKMF DHE SHTËPISË PËR KOMUNITETE”**, dhe në komision caktohen:
 1. **Brahim Hetemaj**, Udh. I sektorit për Shëndetësi;
 2. **Shefqet Shatri**, Infermier në shtëpinë për Komunitete;
 3. **Sevdije Shabanaj**, kryeinfermiere në QKMF.
2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin **“FURNIZIM ME MEDIKAMENTE TE TERAPISE SE PËRGJITHSHME, PËR NEVOJA TE QKMF DHE SHTËPISË PËR KOMUNITETE”**, si dhe do t'i kryej punët dhe përgjigjesit tjera të cilat janë në natyrën e ketij komisioni .
3. Vlerësimin i ofertave do ta kryej Komisioni mbrenda tri ditëve të punës dhe për punën e kryer do ti raportoj Kryetarit të Komunes.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-82/2021	Data: Datum: 23.03.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Mirembajtja e Rrugëve Lokale te Rendit te IV-te" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-862-121 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-002-121, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Mirembajtja e Rrugëve Lokale te Rendit te IV-te" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-862-121 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-002-121 dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe
- 1.3. **Dukagjin Hoxhaj**, Inxh. i komunikacionit, Zyrtar për Regjistrim të Adresave, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Mirembajtja e Rrugëve Lokale te Rendit te IV-te" si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-83/2021	Data: Datum: 24.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-10281, të datës 19.03.2021, të parashtruar nga znj.Sherife Zogaj, nga fsh.Kaliqan, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-553-10281, të datës 19.03.2021, e parashtruar nga znj. znj.Sherife Zogaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore(Kimioterapisë), dhe i lejohen 200 litra karburant, për 2 (dy)muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë znj.Sherife Zogaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

znj.Sherife Zogaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-10281, të datës 19.03.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Sherife Zogaj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për ë Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: znj.Sherife Zogaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-87/021	Data: Datum: 25.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shqyrtoj kërkesën Nr.08-553-7732 të datës 01.03.2021, të parashtruar nga Fillloreta Danaj nga fsh.Vrella, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për nënën Ajkuna Blakaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa Nr.08-553-7732 e datës 01.03.2021 e parashtruar nga Fillloreta Danaj, për përkrahje financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për nënën Ajkuna Blakaj dhe i ndahen **200€(dyqind euro)** nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, si ndihmë momentale për shpenzimet e varrimit dhe shfuqizohet Vendimi Nr.01-904/2020 i datës 09.12.2020, pasi që nuk është bërë transferi në mungesë të mjeteve financiare.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Fillloreta Danaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Fillloreta Danaj, ka parashtruar kërkesën Nr.08-553-7732 të datës 01.03.2021, e cila ka kërkuar përkrahje financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për nënën Ajkuna Blakaj.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendures dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e lendes shihet se Fillloretes i ka vdekur nëna Ajkuna Blakaj, e cila e ka gjendjen e vështirë ekonomike dhe është perkujdesur për nënën, për këtë arsye përkrahet me mjete financiare për shpenzimet e varrimit të nënës në shumë prej **200€(dyqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Fillloreta Danaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit njoftohen: Fillloreta Danaj, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-88/2021	Data: Datum: 26.03.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Sanimi i Gjendjes nga Fatkeqësitë Natyrore-Furnizimi me Material Ndërtimor" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-957-121 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-007-121, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Sanimi i Gjendjes nga Fatkeqësitë Natyrore-Furnizimi me Material Ndërtimor" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-957-121 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-007-121 dhe në komision caktohen:

1.1. Hekuran Rugova, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, Kryesues i Komisionit;

1.2. Naser Nimanaj, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar

1.3. Blerim Bujupi, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Sanimi i Gjendjes nga Fatkeqësitë Natyrore-Furnizimi me Material Ndërtimor" si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-89/021	Data: Datum: 30.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-11215, të datës 29.03.2021, e parashtruar nga Brahim Hetemaj nga fshati Orrobërdë, Komuna e Istogut, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së prindërit-babait (Sadik Hetemaj), dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-11215, e datës 29.03.2021, e parashtruar nga Brahim Hetemaj, Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes e babait (Sadik Hetemaj) dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej **389.20 €** (treqind e tetëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent) nga nenëprogrami buxhetor Administrata në Shëndetësi (73026), kategoria ekonomike paga dhe mëditje kodi ekonomik 11155-shtesat dhe kompensimet tjera (vendim) si ndihmë për familjen e të lartpërmendurit.
2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Brahim Hetemaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Brahim Hetemaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-90/2021	Data: Datum: 31.03.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën Nr.01-016-11274 të datës 30.03.2021, të parashtruar nga komuniteti i fsh. Vrellë të cilin e përfaqëson Adnan Dreshaj nga fsh. Vrellë Komuna e Istogut për përkrahje me karburant për heqjen e borës në rrugën malore Shymek-Carravodë që të jetë e kalueshme deri të kufiri ku për ketë ka bërë kërkesë Nr.01-016-5688 të datës 10.02.2021 Policia e Kosovës njësi në Istog për patrullimin në atë pjesë për siguri të qytetarëve dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-016-11274 të datës 30.03.2021, të parashtruar nga komuniteti i fsh. Vrellë të cilin e përfaqëson Adnan Dreshaj për përkrahje me karburant për pastrimin e borës në rrugën malore Shymek-Carravodë që të jetë e kalueshme deri të kufiri ku për ketë ka bërë kërkesë Nr.01-016-5688 të datës 10.02.2021 Policia e Kosovës njësi në Istog dhe përkrahen me 1000 litra karburant, nga Zyra e Kryetarit.
2. Obligohet Zyrtari për Transport që të pajisë Adnan Dreshaj me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyrtari për Transport.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Adnan Dreshaj, ka parashtruar kërkesën Adnan Dreshaj për përkrahje me karburant për pastrimin e borës në rrugën malore Shymek-Carravodë që të jetë e kalueshme deri të kufiri ku për ketë ka bërë kërkesë Nr.01-016-5688 të datës 10.02.2021 Policia e Kosovës njësi në Istog për patrullimin në atë pjesë për siguri të qytetarëve.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Për shkak të gjendjes së sigurisë për qytetaret e Komunës së Istogut është e nevojshme të pastrohet rruga nga bora Shymek-Corrovodë dhe për ketë qëllim përkrahen me 1000 litra karburant pasi që komuniteti i fsh. Vrellë të cilët kanë participuar me mjete financiare në shumë prej 2,000.00€(dy mijë euro).

Zyrtari për Transport do ti pajisë me vërtetim për furnizim me karburante nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Zyrtari për Transport do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Adnan Dreshaj, Zyrtari për Transport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

